



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 544 prot.

Shkodër, më 7.3. 2025

VENDIM

Nr. 12, datë 03.03.2025

PËR

“STREHIMIN EMERGJENT TË ZJ. G.T DHE FËMIJËVE TË MITUR NË NJËSITË E BANIMIT TEK BANESAT SOCIALE ME QIRA (ISH-KONVIKTI I SHKOLLËS VETERINARE).”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 03.03.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24 pika 2, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 2, pika 25 të ligjit Nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar; pikës 19 të VKM - së Nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; VKB Nr. 24 datë 10.5.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve pranë banesave sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës “Veterinare” dhe të “Rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër”; VKB Nr.21 datë, 29.04.2024 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër”; Vendimit Nr.36 (481), datë 11.02.2025 “Për Lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes” së Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratojë strehimin emergjent të znj. G.T dhe fëmijëve të mitur në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira (ish-Konvikti i Shkollës Veterinare”).

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 36 vota

Vota Pro	36
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	04.03.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULLI

